



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prilbena / Prodato Received / Delivery	23 - 11 - 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSK	7366	2022	1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.828/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.828/2022 të datës 27.09.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "kontestim konkursi-lëvizje brenda kategorisë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.828/2022 e datës 27.09.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01Nr.020-40136 i datës 22.08.2022 i Kryesuesit të Komisionit të Vlerësimit.

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur me numë reference NR00009307 nga Komuna e Drenasit sipas njoftimit të datës 27.06.2022 për aplikim nga data 16.07.2022 deri me datë 25.07.2022 për lëvizje brenda kategorisë, në pozitën „Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa“, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Drenasit.

Menaxherja e Personelit në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve të kandidatëve, me datë 29.07.2022 ka nxjerrë rezultatet e verifikimit paraprak me numër protokollit 01Nr.111/01-29101, dhe ankuesja i ka plotësuar kushtet e pozitës së shpallur me numë reference NR00009307, dhe është përfshirë në listën e shkurtër e cila është ftuar për intervistë me gojë me datën 09.08.2022, ndërsa më datën 10.08.2022 me Njoftimin 01.Nr.111/01-29101 është njoftuar lidhur

me vlerësimin e rezultateve nga intervista me gojë nga Komisioni i vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë së procedurës ka përfunduar pa fitues.

Ankuesja kundër Njoftimit me numër 01.Nr.111/01-29101 të datës 10.08.2022, ka parashtruar ankesë po të njëjtën datë gjegjësisht me datë 10.08.2022 tek Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunen e Drenasit, ndërsa ky i fundit me datë 22.08.2022 ka nxjerrë Vendim me numër 01Nr.020-40136 me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër 01Nr.020-40136 me datë 22.08.2022 të Kryesuesit të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunen e Drenasit, brenda fatit ligjor me datë 27.09.2022 ka parashtruar ankesë përmes adresës elektronike: ankesa.kpmschck@rks-gov.net në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se nuk është vlerësuar drejt dhe nga Komisioni i Vlerësimit respektivisht ajo pretendon se në intervistë me gojë i është përgjigjur të katër (4) pyetjeve, përveç pyetjes së një anëtarit të Komisionit -zyrtares së prokurimit, andaj vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë nuk është real.

Për shkak të kompletimit të lëndës gjegjësisht mungesës së provave, sipas kërkesës së Kryetares së Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.11.2022 ka nxjerr Vendim VK.Nr.143/2022 përmes të cilit ka shtyrë afatin për vendimmarrje për ankesën e ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 17.10.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunë të Drenasit, ndërsa kjo e fundit me datë 18.10.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 6276/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, po ashtu me datë 08.11.2022, Këshilli ka kërkuar prova shtesë tek Njësia e personelit, e cila me datë 11.11.2022 ka bashkëngjitur provat e kërkuar me numër protokollit 7025/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike , për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova : Ankesën me numër të protokollit 5690/2022 të datës 27.09.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes E-mail i datës 27.09.2022, e plotësuar me datë 27.09.2022 numër të protokollit 5700/2022 prej 1/9 faqe; E-mail i datë 27.09.2022 për konfirmimin e pranimit të ankesës nga KPMSHCK-së; Njoftimi i datës 10.08.2022 për përfundimin e procesit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë me numër Ref. RN00009307; Kopje e konkursit ; E-mail i datës 27.09.2022; Njoftim i datës 08.08.2022 për intervistë me gojë; Njoftim i datës 08.08.2022 për listë shkurtër të procedurës për lëvizje brenda kategorisë për kandidatin/ankuesen; Vendimi me numër 01 nr.020-40136 i datës 22.08.2022 nga komisioni për pranim; Konkursi i shpallur sipas njoftimit të datës 27.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 18.10.2022, me numër protokollit 6276/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, dhe e plotësuar me datë 11.11.2022 sipas Kërkesës së datës 08.11.2022, të Këshillit, nga Njësia e personelit, me numër protokollit 7025/2022; Vendimi me numër protokollit 01-020-40136 të datës 03.08.2022 të Kryetarit të Komunës së Drenasit për themelimin e Komisioni për

Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë; Akt emërimit i datës 21.04.2022; Akt emërimit i datës 06.12.2019; Akt emërimit i datës 27.12.2017; Akt emërimit e datës 07.06.2012; Konfirmim për transferimin e nëpunësit e datës 06.06.2022; Rezultati i verifikimit paraprak i datës 29.07.2022; Pyetje e parashtruara nga Komisioni ; E-mail i datës 08.08.2022 nga Zyra e personelit; Njoftimi përfundimtar i datës 10.08.2022 me numër 01Nr.111/01-29101; E-mail i datës 08.10.2022; Procesverbali nga komisioni i datës 09.08.2022; tabela e nxjerrë nga sistemi SIMBNJ-së i datës 10.11.2022; Njoftimit me numër protokolli 01 Nr.070/01-29101 të datës 09.08.2022; Renditja përfundimtare e datës 23.08.2022 nga sistemi SIMBNJ-së; E-mail i datës 20.09.2022; Prova shtesë sipas kërkesës së datës 08.11.2022 drejtuar Njesisë personelit të Komunës së Drenasit; Aplikacioni i ankueses, me shkresat e bashkangjitura: Diplomë Nr.1530 Universitare e datë 25.10.2010; Diplomë Nr.907 Universitare e datë 07.06.2016; Certifikatë e datës 01.11.2017; Certifikatë e datës 09.01.2015; shkresë nga SHKÇAK-së i datës 13.01.2011; Akt emërim i datës 02.08.2017; Referencë e datës 08.10.2015; Vërtetim i datës 21.07.2022; Referencë e datë 01.02.2013; Letër Rekomandimi i datës 26.05.2008; Referencë e punës e datës 14.07.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, i datë 06.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019, i datë 25.12.2020; Aplikacioni i z.V.I., me shkresat e bashkangjitura: Diplomë Nr.841/14 Universitare e datës 23.07.2014; Pasqyra e notave e datës 09.07.2015 lëshuar nga Kolegji AAB, Certifikatë e datës 29.02.2012; Certifikatë e datës 25.05.2016; Certifikatë e datës 24.09.2013; Vendim i datës 30.06.2017; Vërtetim i datës 25.08.2016; Vërtetim i datës 08.05.2017; fletë rekomandim i datës 15.02.2013; Mirënjohje nga KQZ; Referencë e datës 28.01.2008; Letër Rekomandimi i datës 27.02.2009; Njoftim i datës 29.12.2011; Akt emërimit i datës 05.06.2017; Ndryshim plotësim i akt emërimit i datës 30.10.2018; Vendim i datës 30.10.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, e datës 27.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020, i datës 25.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Drenasit, sipas njoftimit të datës 27.06.2022 ka shpallur konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009307 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa*, me afatin për aplikim nga data 16.07.2022 deri me datë 25.07.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 38 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Drenasit me rastin e shpalljes së konkursit të datës 27.06.2022 ka përcaktuar kriteret e përgjithshme formale:

- Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e studimeve Universitare me të paktën 240 kredi/ECTS, Fakulteti Ekonomik apo ekuivalente me to (Në rast kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor),*
- Përvojë e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Sipas shkresave të lëndës është konstatuar se në konkursin me numër referencë RN00009307 për pozitën *„Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa”*, e shpallur nga Komuna e Drenasit, kanë aplikuar

dy kandidatë, ndërsa vetëm një kandidate në këtë rast ankuesja është vlerësuar se i plotëson kriteret e konkursit e cila me datën 29.07.2022 është njoftuar individualisht përmes shkresës me numër 01nr.111/01-29101, se ka plotësuar kriteret për listën e shkurte dhe është ftuar për intervistë me gojë me datën 09.08.2022, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se verifikimi paraprak për kandidaten që ka plotësuar kushtet e konkursit është vlerësim i drejtë, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: *"1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin"*.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale dhe ligjore gjegjësisht ajo pretendon se Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë jetëshkrimit dhe pergjigjeve të cilat i ka dhënë në intervistën me gojë sepse ajo pretendon se është përgjigjur ne te gjitha pyetjet e katër (4) anëtareve të Komisionit, përveç pyetjes së parashtruar nga ana e një anëtari të Komisionit- zyrtares së prokurimit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ky pretendim i ankueses është i paqëndrueshëm sepse në bazë të nenit 47 paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"1. KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës..4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë, si dhe nenit 22 paragrafit 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.3 të kësaj rregulloreje ku përcaktohet se 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri ne njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri ne tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri ne shtate (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri ne pesë (5) pikë për trajnimet"*, ndërsa Komisioni i Vlerësimit në bazë të dokumentacioneve ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidaten ku ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 18 pikë, andaj në këtë rast pretendimi i ankueses është i pabazuar sepse vlerësimi për këtë pjesë është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se komisioni i Vlerësimit nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë pergjigjeve të cilat i ka dhënë në intervistën me gojë, Kolegji konstaton se pretendimet e ankueses janë të pa qëndrueshme sepse ankuesja nuk ka arritur që të argumentoj me asnjë provë dhe dëshmi se Komisioni i ka bere vlerësim te padrejte, respektivisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës se në bazë dëshmimeve te ofruara konkretisht Vendimit me numër protokolli 01-020-40136 të datës 03.08.2022 të Kryetarit të Komunës së Drenasit ka konstatuar se Komisioni për Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Drenasit është themeluar në pajtim me nenin 46 paragrafin 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili konform këtyre dispozitave ligjore është përgjegjës për zhvillimin e procesit të rekrutimit dhe se i njëjti është i pavarur sa i përket vlerësimit të kandidateve, po ashtu në bazë të ankesës së datës 27.09.2022 të

parashtruar nga ankuesja e cila deklaroi respektivisht e pranon se nuk i është përgjigjur pyetjes së parashtruar nga ana e një anëtari të Komisionit- zyrtares së prokurimit, si dhe përgjigjes në ankesë të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit, konkretisht Njoftimit me numër protokoll 01 Nr.070/01-29101 të datës 09.08.2022 është vërtetuar se kandidatja në të gjitha fazat e rekrutimit, është vlerësuar drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore nga verifikimi paraprak deri tek faza e vlerësimit gjegjësisht nga vlerësimi i përgjithshëm, vlerësimi të jetëshkrimit, vlerësimi nëpërmjet intervistës me gojë dhe deri tek llogaritja e rezultatit përfundimtar, andaj Kolegji konstaton se vlerësimi i kandidates është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 22, 47 dhe të nenit 48 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Po ashtu nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit vëren se në këtë procedure ka marra pjesë vetëm një kandidatë në këtë rast ankuesja dhe nga intervista me gojë dhe jetëshkrimi ka arritur të grumbulloje vetëm 31.2 pikë, respektivisht nuk ka arritur të grumbulloje të paktën 60 pikë gjegjësisht nuk ka arritur pikët e mjaftueshme, për tu përzgjedhur si kandidatë e sukseshme për pozitën *Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa*, andaj mbi këtë fakt Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Drenasit, me rastin e publikimit të Njoftimit të datës 10.08.2022 për përfundimin e procesit të vlerësimit nga intervista me gojë dhe jetëshkrimi gjegjësisht njoftimit se lista përfundimtare është pa fitues për pozitën *„Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa“* ka vepruar në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“ 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”*,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës po ashtu ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit, me datë 10.08.2022 e ka njoftuar po ashtu edhe kandidaten /ankuesen me Njoftimin me numër 01.Nr.111/01-29101 lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozitën *‘Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa’*, e cila ka përfunduar pa fitues, duke e njoftuar edhe me pikët e arritura gjithsejtë 31.2, në pajtim me nenin 49 paragrafin 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se *“ Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit “*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komisioni me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 01 Nr.020-40136 të datës 22.08.2022 sipas ankesës së ankueses të datës 10.08.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 27.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009307 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa*, me afatin për aplikim nga data 16.07.2022 deri me datë 25.07.2022, është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të

nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër, A.nr.828/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Drenas
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë Drenas dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.